



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
TIK në mësimdhënien e gjuhës së huaj

Ngarkesa: 6 Kredite (= 60 orë) 3 Kredite Leksione - (= 30 orë); 3 Kredite seminare - (= 30 orë);

Viti / Semestri: Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në "Mësuesi e Gjuhës Angleze "

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore:

Të pajisë studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike për integrimin e teknologjisë në mësimdhënien e gjuhës angleze në shkollat e mesme. Të zhvillojë te studentët ndërgjegjësimin për rëndësinë e përdorimit të teknologjisë në përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe të të nxëniet. Të nxisë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të mjeteve teknologjike dhe aplikacioneve bashkëkohore.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të njohë studentët me mjete, aplikacione dhe platforma teknologjike që ndihmojnë në planifikimin dhe zhvillimin e orës mësimore (si: wikis, blogs, Google Classroom etj.).
2. Të aftësojë ata për të përdorur në mënyrë efektive materiale online dhe burime të ndryshme autentike për qëllime didaktike.
3. Të përmirësojë aftësitë komunikuese dhe bashkëpunuese përmes përdorimit të forumeve, rrjeteve sociale dhe mjeteve bashkëkohore për feedback dhe ndërveprim me studentët.
4. Të zhvillojë kompetenca për ndërtimin e faqeve interneti që mund të përdoren në funksion të mësimdhënies.

Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të lëndës, studenti duhet të jetë në gjendje të:

1. Kërkojë dhe përzgjedhë materiale autentike online që ndihmojnë në ndërtimin e një ore mësimore efektive.
2. Integrojë në mënyrë aktive mjete teknologjike, media dhe metoda të ndryshme në mësimdhënien.
3. Ndërtojë dhe menaxhojë një faqe interneti në funksion të orës mësimore.
4. Përdorë forume, rrjete sociale dhe platforma online për të bashkëpunuar, komunikuar dhe dhënë feedback për procesin e mësimin dhe mësimdhënies.